



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI

Mbi përqendrimin nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Hec Ulëz Shkopet Sh.a nga Kurum International Sh.a

Në datën 12 Mars 2013, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Kontratës për shitjen e 100 për qind të aksioneve të shoqërive Hec Ulëz Shkopet Sh.a, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës dhe shoqërisë Kurum International Sh.a”, të datës 11 Shkurt 2013, me objekt përftimin e kontrollit të Hec Ulëz Shkopet Sh.a nga Kurum International Sh.a nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse në përqendrim është si vijon:

- **Kurum International Sh.a:** ka si objekt veprimtaritë kryesisht në prodhimin, pëprunimin, tregtimin, import-eksportin e hekurit të ndërtimit, grumbullimin, përpunimin, tregtimin, import-eksport të skrapeve të ndryshëm në zonën e ish-Kombinatit Metalurgjik, etj.;
- **Hec Ulëz Shkopet Sh.a Sh.a:** është një ndërmarrje shtetërore e krijuar me ligj dhe e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al